



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-138899/20 dt. 12.08.2020, të pronareve Ismet Gashi dhe Besim Hasani nga Prishtina, dhe investitorit ”Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Bahri Fazliu” hyrjet nr. 58, 60, 62, 64, 66, 68, 70, dhe “Bardhyl Çausi” hyrjet nr. 51, 53, 55, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 24.02.2021, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** Ismet Gashi dhe Besim Hasani nga Prishtina, dhe investitorit ”Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-138899/20 dt. 12.08.2020, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “C15/09/A” dhe ndërtesës “C15/09/A” me etazhitet 2B+S+P+8/9 e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-31454 dt. 25.01.2013, në parcelat kadastrale nr. 689/2, 689/4 dhe 690/4 të evidentuar në certifikatat e pronësisë P-71914050-00689-2, P-71914050-00689-4 dhe P-71914050-00690-4 ZK Matičan, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, të ndërtuara në rrugën “Bahri Fazliu” hyrjet nr. 58, 60, 62, 64, 66, 68, 70, dhe “Bardhyl Çausi” hyrjet nr. 51, 53, 55, në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**VI.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

Njehërit obligohet Drejtoria e Kadastrit që në pjesën tabelar të certifikatës së pronësisë “Vërejtjet - Primedbe – Caveats” të shënonë përshkrimin “Me Vendimin e lejes ndërtimore 05 Nr. 351-31454 dt. 25.01.2013 dhe me këtë certifikatë janë trajtuar në tersi parcelat nr.690-4 dhe 689-4 ZK Matičan.

**V.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## A r s y e t i m

Pronareve Ismet Gashi dhe Besim Hasani nga Prishtina, me investitor ”Partner & Dervisholli” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Ekrem Qarolli nga Prishtinë, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-138899/20 dt. 12.08.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesës “C15/09/A” dhe ndërtesës “C15/09/A” me etazhitet 2B+S+P+8/9, e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C1”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të në parcelat kadastrale nr. 689/2, 689/4 dhe 690/4 të evidentuar në

certifikatat e pronësisë P-71914050-00689-2, P-71914050-00689-4 dhe P-71914050-00690-4 ZK Matiçan, ndërtuar sipas Aktëvendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-31454 dt. 25.01.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 356-38603 dt. 20.07.2020, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspeksioni i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Yllka Rraci; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Besart Abdylit; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillës dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikëqyrësi Besim Abrashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Bujar Komoni; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Edona Sheqerolli me nr. të licensës 101;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillës dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**05 NR. 391/02-138899/20 DT. 24.02.2021**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu

*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi

*Mimoza Berisha Prestreshi*

Drejtori,  
Ardian Olluri



